



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KONKURRENCËS  
KOMISIONI I KONKURRENCËS

Nr. 36 / prot.

27

Tiranë, më 26.03.2025

VENDIM

Nr. 117, Datë 26.03.2025

**“PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NË TREGUN E NDËRMJETËSIMIT PËR SIGURIMIN E JETËS PËR KREDITË TË CILAT KËRKOJNË SIGURIM JETE PËR NDËRMARRJET: OTP BANK ALBANIA SHA, BANKA KOMBËTARE TREGTARE SHA, CREDINS BANK SHA, BANKA RAIFFEISEN SHA, BANKA E TIRANËS SHA, INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA SHA, UNION BANK SHA, E-BUSINESS SOLUTIONS SHPK, BANKA E BASHKUAR E SHQIPËRISË SHA, BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA DHE ABI BROKER SIGURIMESH SHA DHE NË TREGUN E KREDIDHËNIES ME SIGURIM JETE PËR KREDITË QË JEPEN BRENDË BANKËS BANKËS SË PARË TË INVESTIMEVE SHA DHE BANKËS PROCREDIT SHA”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 26.03.2025, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete për ndërmarrjet: OTP Bank Albania SHA, Banka Kombëtare Tregtare SHA, Credins Bank SHA, Banka Raiffeisen SHA, Banka e Tiranës SHA, Intesa SanPaolo Bank Albania SHA, Union Bank SHA, E-Business Solutions SHPK, Banka e Bashkuar e Shqipërisë SHA, Banka Amerikane e Investimeve SHA dhe Abi Broker Sigurimesh SHA dhe në tregun e kredidhënies me sigurim e jetë për kreditë që jepen brenda bankës Bankës së Parë të Investimeve SHA dhe Bankës Procredit SHA.

**Baza Ligjore:** Neni 4, neni 9, neni 24, germa (d), neni 26 dhe neni 43, pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”.

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, të Autoritetit të Konkurrencës:

## VËREN SE :

1. Nisur nga një ankesë e depozituar pranë Autoritetit të Konkurrencës, me qëllim fillimin e procedurave hetimore për të shmangur pengimet, kufizimet, shtrembërimet e konkurrencës në tregun e sigurimeve të jetës për kredi, Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës bazuar në nenin 28, germa (a), të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, nisi procedurën e monitorimit në tregun e sigurimit të jetës për kredi, duke kërkuar informacion nga bankat lidhur me këtë treg.
2. Nga vlerësimi i informacionit gjatë monitorimit, si dhe nga faqja zyrtare e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare u konstatua se, shoqëritë e sigurimit të cilat ushtrojnë aktivitet në tregun e sigurimit të jetës janë: Sigal Life Uniq Group Austria SHA me 44.37%, Insig Jeta SHA 21.72%, Albsig Jetë SHA me 17.92% dhe Sicred SHA me 15.99% të tregut të sigurimit të jetës sipas raportit statistikor të vitit 2023.
3. Gjithashtu nga vlerësimi i informacionit gjatë monitorimit vihet re se, bankat e licensuara si “Broker” paraqesin portofolin e shoqërive të sigurimit me të cilat kanë kontrata aktive, dhe më pas lejojnë klientët të bëjnë përgjedhjen e tyre pasi u janë shpjeguar kushtet e ndërmjetësimit përsa i përket produktit të sigurimit të jetës. Pavarësisht shpjegimit të sjellë në mënyrë shkresore nga bankat e nivelit të dytë, rezulton se përqindja e tregut total të sigurimit të jetës sipas raportit statistikor të AMF për vitin 2023, nuk reflektohet tek ndarja e portofolit të sigurimit të jetës për hua ku SiCRED SHA rezulton të ketë përqindje tregu të tillë si 0.3% tek BKT SHA, 0.3% tek Raiffeisen bank SHA, 0.1% tek Intesa San Paolo bank SHA, 1% tek Pro Credit bank SHA etj. Nisur nga fakti që një përqindje e tillë tregu për një produkt të vetëm, nuk reflekton ndarjen totale të tregut të sigurimit të jetës, mund të vijë si pasojë e sjelljeve përjashtuese me karakter antikonkurruesh duke bërë që klientët mos të jenë të lirë të zgjedhin sigurimin e jetës për kredi nga shoqëri sigurimi të përgjedhura nga vetë ata.
4. Për këto arsy, Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin nr. 1130, datë 07.11.2024 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e sigurimit të jetës për kredi”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit të paraprak në sektorin bankar në bankat e nivelit të dytë, përsa i përket produktit të sigurimit të jetës për kredi, për periudhën kohore nga 07.11.2021 deri në 07.11.2024.
5. Nisur nga volumi i informacionit të kërkuar, disa nga bankat kanë kërkuar shtyrje afati për dërgimin e informacionit si dhe Autoriteti i Konkurrencës i është drejtuar bankave dhe shoqërise të sigurimit duke rikërkuar saktësim apo plotësim informacioni, dhe për këto arsy koha e mbetur në dispozicion nga momenti i depozitimit të informacionit është e pamjaftueshme për përpunimin, vlerësimin dhe kryerjen e analizës së sjelljes së bankave në tregun e sigurimit të jetës për kredi, duke bërë të pamundur përfundimin e procedurave dhe dorëzimin e raportit brenda afatit në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 1130, datë 07.11.2024.
6. Për këto arsy, Komisioni i Konkurrencës Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 1159, datë 13.02.2025, “Për një ndryshim në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 1130, datë 07.11.2024 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e sigurimit të jetës për kredi”.”, vendosi që pika “III”, të ndryshohet si vijon: “III. Raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se data 3 Mars 2025.”.

7. Sigurimi i Jetës për Kredi ofrohet për personat që marrin kredi në bankë dhe i mbron ata dhe familjarët nga rreziku i mos shlyrjes së hua-së si pasojë e humbjes së jetës së kredimarrësit. Ky sigurim është një garanci financiare si për bankën (nga rreziku i mos shlyrjes së huasë si pasojë e humbjes së jetës së kredimarrësit) ashtu edhe për kredimarrësin, personin e siguruar, duke çliruar familjen e personit kredimarrës nga pagesa e kredisë së mbetur.
8. Tregu i sigurimeve të jetës në Republikën e Shqipërisë funksionon në zbatim të ligjit nr. 52/2014, "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit", i cili rregullon krijimin, veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e shoqërive të sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit, me qëllim që tregu i sigurimeve të veprojë në një mjesid të sigurt, të qëndrueshëm dhe transparent, në mbrojtje të të drejtave dhe interesave të konsumatorit.
9. Ligji nr. 52/2014 parashikon si lloje të ndërmjetësimit, veprimtarinë e agjentit dhe brokerit, duke përcaktuar se edhe bankat e nivelit të dytë mund të pajisen me licensë për të ushtruar këtë veprimtari. Konkretisht, nen 194, pika 4 parashikon se "Veprimtaria e agjentit mund të kryhet edhe nga bankat, degët e bankave të huaja ose subjektet financiare jobanka, pasi të kenë marrë më parë miratimin nga Banka e Shqipërisë, si dhe subjekte të tjera, sipas rregullave të përcaktuara nga Autoriteti" ndërsa nen 204 pika 5 parashikon se "Veprimtaria e brokerimit mund të kryhet edhe nga bankat dhe/ose degët e bankave të huaja pasi të kenë marrë më parë miratimin nga Banka e Shqipërisë, sipas rregullave të përcaktuara nga Autoriteti".
10. Në bazë të nenit 194 të Ligjit nr. 52/2014, veprimtaria e agjentit në sigurime kryhet në emër dhe për llogari të shoqërisë së sigurimit dhe përfshin prezantimin, propozimin dhe aktivitete të tjera përgatitore mbi kontratën e sigurimit, si dhe nënshkrimin e saj nga i siguruari. Veprimtaria e agjentit në sigurime mund të kryhet edhe në emër të disa shoqërive të sigurimit, nëse shoqëritë e sigurimit kanë rënë dakord me marrëveshje të shkruar midis tyre.
11. Lidhur me veprimtarinë e brokerimit, në bazë të nenit 202 të Ligjit Nr. 52/2014, përfshin të gjitha ato veprimtari, si prezantimi, propozimi, apo aktivitete të tjera përgatitore, të cilat kanë të bëjnë me negocimin me shoqërinë e sigurimit në emër dhe për llogari të konsumatorit, për t'i mundësuar nënshkrimin e një kontrate sigurimi, sipas kërkesave dhe nevojave të tij. Gjithashtu, përfshin edhe assistencën për ushtrimin e të drejtave që rrjedhin nga kontrata e sigurimit, veçanërisht zgjidhjen e kërkesave për dëmshpërbirim nga shoqëria e sigurimit, në emër dhe për llogari të konsumatorit. Brokeri/shoqëria e brokerimit ndërmjetëson për lidhjen e kontratave të sigurimit vetëm me shoqëritë e sigurimit të licencuara.
12. Produkti i sigurimit të jetës është i lidhur me kreditin, e cila kërkon sigurim jete dhe në varësi të procedurave të brendshme të bankave, shitet pas aprovimit të kredisë dhe firmosjes së kontratës së kredisë. Për të lehtësuar procedurat për klientët, disa banka kanë shtuar gamën e shërbimeve të tyre duke u licensuar si agjentë apo brokér pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) në mënyrë që klienti kredimarrës, të mos vonohet me procedurat e sigurimit të jetës për kredi, por të vijojë sa me shpejt, duke kryer sigurimin e jetës në degën e bankës ku ka zgjehur të marrë kreditin.
13. Referuar sa më sipër, AMF në Republikën e Shqipërisë ka licencuar 4 banka të nivelit të dytë si broker në sigurime për klasat e jetës dhe 1 bankë të nivelit të dytë si agjent në sigurime për klasat e jetës. Bankat e licencuara si broker në sigurime për klasat e jetës janë: Banka Raiffeisen, Banka

Kombëtare Tregtare, Tirana Bank dhe OTP Bank, ndërsa banka e licencuar si agjent për të njëjtën kategori është Credins Bank. Disa banka të nivelit të dytë, edhe pse jo të licencuara, kanë lidhur marrëveshje me shoqëri sigurimi për klasat e jetës, duke marrë automatikisht rolin e ndërmjetësuesit.

14. Në zbatim të Rregullores “Për administrimin e rrezikut të kredisë”<sup>1</sup>, bankat e nivelit të dytë, sipas klasifikimit të kredisë, janë të detyruara të sigurojnë kreditinë mbështetur në analizën dhe vlerësimin e cilësisë e kolateralit/ose garancisë së vendosur për marrjen e kredisë.
15. Në rregulloren “Për kreditinë konsumatore dhe kreditinë hipotekare”<sup>2</sup>, neni 7, informacioni kontraktor që duhet të jepin bankat për klientët duhet të përbajë veç të tjerave edhe, “garancitë e vendosura për të siguruar ekzekutimin e kontratës së kredisë, mënyrën e vënies së tyre në ekzekutim, dhe kontratat e sigurimit të jetës ose të pronës (kur janë të aplikueshme).
16. Mbi bazën e këtij detyrimi, klientët njihen që në momentin e nënshkrimit të një kontrate kreditie konsumatorë apo hipotekore me detyrimin e sigurimit të jetës, aty ku është e aplikueshme, për gjithë periudhën e mbajtjes së detyrimit. Nëpërmjet këtij detyrimi, banka sigurohet që në rast ndodhje të një ngjarjeje ndaj kredi-marrësit, detyrimi i kredi-marrësit mbulohet nga shoqëritë e sigurimit.
17. Për sa më sipër, tregu përkatës i produktit është:
  - i. tregu i ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete në bankën Banka Kombëtare Tregtare .
  - ii. tregu i ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete në bankën Raiffaisen.
  - iii. tregu i ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete në bankën OTP.
  - iv. tregu i ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete në bankën Tirana.
  - v. tregu i ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete në bankën Credins.
  - vi. tregu i ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete në bankën Intesa San Paolo.
  - vii. tregu i ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete në bankën Union.
  - viii. tregu i ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete në bankën Amerikane të Investimeve.
  - ix. tregu i ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete në bankën e Bashkuar të Shqipërisë.
  - x. Për bankën Banka e Parë e Investimeve është tregu kredidhënies me sigurim e jete për kreditë që jepen brenda bankës Banka e Parë e Investimeve.
  - xi. Për bankën Procredit është tregu kredidhënies me sigurim e jete për kreditë që jepen brenda bankës Procredit.

---

<sup>1</sup> Miratuar me Vendimin nr. 62 datë 14.09.2011, Këshilli Mbikëqyrës BSH.

<sup>2</sup> Miratuar me Vendimin nr. 48 datë 01.07.2015, Këshilli Mbikëqyrës BSH.

18. Tregu gjeografik përfshin zonën në të cilën ndërmarrjet ofrojnë dhe kërkojnë produkte dhe/ose shërbime, në të cilën kushtet e konkurrencës janë homogjene. Meqenëse, produkti i sigurimit të jetës është i detyrueshëm të blihet në momentin që banka aprovon kreditin që klienti dëshiron të marrë, atëherë si treg gjeografik do të konsiderohet vetëm territori i bankës së nivitet të dytë që ka aprovuar atë kredi. Për këtë arsyе tregu gjeografik do të përcaktohet:
- i. tregu gjeografik për Bankën Kombëtare Tregtare do të konsiderohet territori ku kryen veprimtarinë Banka Kombëtare Tregtare.
  - ii. tregu gjeografik për bankën Raiffeisen do të konsiderohet territori ku kryen veprimtarinë Banka Raiffeisen.
  - iii. tregu gjeografik për bankën OTP do të konsiderohet territori ku kryen veprimtarinë Banka OTP.
  - iv. tregu gjeografik për bankën Tirana do të konsiderohet territori ku kryen veprimtarinë Tirana Bank.
  - v. tregu gjeografik për bankën Credins do të konsiderohet territori ku kryen veprimtarinë Banka Credins.
  - vi. tregu gjeografik për bankën Intesa San Paolo do të konsiderohet territori ku kryen veprimtarinë Banka Intesa San Paolo.
  - vii. tregu gjeografik për bankën Union do të konsiderohet territori ku kryen veprimtarinë Union Bank.
  - viii. tregu gjeografik për bankën American Bank of Investment do të konsiderohet territori ku kryen veprimtarinë American Bank of Investment.
  - ix. tregu gjeografik për bankën e Bashkuar të Shqipërisë do të konsiderohet territori ku kryen veprimtarinë Banka e Bashkuar e Shqipërisë.
  - x. tregu gjeografik për Bankën e Parë të Investimeve do të konsiderohet territori ku kryen veprimtarinë Banka e Parë e Investimeve.
  - xi. tregu gjeografik për bankën Procredit do të konsiderohet territori ku kryen veprimtarinë Banka Procredit.
19. Pjesët e tregut janë një tregues i rëndësishëm në lidhje me strukturën e tregut dhe rëndësinë e ndërmarrjeve të ndryshme në treg. Megjithatë, Autoriteti interpreton pjesët e tregut në këndvështrimin e kushteve të tregut përkatës dhe në veçanti të dinamikës së tregut dhe të diferencimit të produkteve. Tendenca ose zhvillimi i pjesëve të tregut me kalimin e kohës, mund të merret në konsideratë për tregjet e paqëndrueshme ose për tregjet ofertues.
20. Praktikat më të mira të vendeve të Bashkimit Evropian sugjerojnë se sa më e madhe të jetë pjesa e tregut dhe sa më e gjatë periudha që ndërmarrjet zotërojnë një pjesë të tillë tregu, aq më e mundur është që ky element të jetë një tregues i rëndësishëm për një pozicion dominues dhe të justifikojë në rrethana të caktuara ndërhyrjen e Autoritetit të Konkurrencës.<sup>3</sup>
21. Nisur nga pjesa e tregut, pengesat e hyrjes në treg, konkurenca potenciale, fuqja kundërvepruese e blerësve dhe karakteristikat e tjera të tregut, rezulton se në mbështetje të nenit 3, pika 5 dhe nenit 8 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës ndërmarrja:
- i. Banka Kombëtare Tregtare SHA në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete në bankën Banka Kombëtare Tregtare, ka pozitë dominuese;

---

<sup>3</sup> Komunikim nga Komisioni Udhëzim mbi sjelljet përjashtuese, lidhur me zbatueshmërinë e nenit 82 -Guidance on the Commission's enforcement priorities in applying Article 82 of the EC Treaty to abusive exclusionary conduct by dominant.

- ii. Raiffeisen Bank SHA në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete në bankën Raiffeisen, ka pozitë dominuese;
- iii. OTP Bank Albania SHA në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete në bankën OTP, ka pozitë dominuese;
- iv. Banka e Tiranës SHA në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete në bankën e Tiranës, ka pozitë dominuese;
- v. Credins Bank SHA në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete në bankën Credins, ka pozitë dominuese;
- vi. Intesa Sanpaolo Bank Albania SHA në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete në bankën Intesa Sanpaolo, ka pozitë dominuese;
- vii. Union Bank SHA në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete në bankën Union Bank, ka pozitë dominuese;
- viii. Banka Amerikane e Investimeve SHA në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete në bankën ABI Bank, ka pozitë dominuese;
- ix. Banka e Bashkuar e Shqipërisë SHA në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete në bankën e Bashkuar të Shqipërisë, ka pozitë dominuese;
- x. Banka e Parë e Investimeve SHA në tregun e kredidhëniec me sigurim e jete për kreditë që jepen brenda bankës Banka e Parë e Investimeve, ka pozitë dominuese;
- xi. Procredit Bank SHA në tregun e kredidhëniec me sigurim e jete për kreditë që jepen brenda bankës ProCredit, ka pozitë dominuese.

22. Nga analiza e sjelljes së ndërmarrjeve në tregun përkatës, vihet re:

- 23. [REDACTED]
- 24. [REDACTED]
- 25. [REDACTED]
- 26. [REDACTED]
- 27. [REDACTED]

28. Sa më sipër, sjellja e ndërmarrjes Banka Kombëtare Tregtare SHA në tregun përkatës, mund të përbëjë shkelje të nenit 4 dhe nenit 9 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

29. [REDACTED]

30. [REDACTED]

31. [REDACTED]

32. [REDACTED]

33. [REDACTED]

34. [REDACTED]

35. [REDACTED]

36. [REDACTED]

37. Sa më sipër, sjellja e ndërmarrjes Banka Raiffeisen SHA në tregun përkatës, mund të përbëjë shkelje të nenit 4 dhe nenit 9 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

38. [REDACTED]

39. [REDACTED]

40. [REDACTED]

41. [REDACTED]

42. [REDACTED]

43. Sa më sipër, sjellja e ndërmarrjes OTP Bank Albania SHA në tregun përkatës, mund të përbëjë shkelje të nenit 4 dhe nenit 9 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

44. [REDACTED]

45. [REDACTED]

46. [REDACTED]

47.

[REDACTED]

48.

[REDACTED]

49.

[REDACTED]

50

[REDACTED]

51. Sa më sipër, sjellja e ndërmarrjes Tirana Bank SHA në tregun përkatës, mund të përbëjë shkelje të nenit 4 dhe nenit 9 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

52

[REDACTED]

53.

[REDACTED]

54.

[REDACTED]

55

[REDACTED]

56. Sa më sipër, sjellja e ndërmarrjes Credins Bank SHA në tregun përkatës, mund të përbëjë shkelje të nenit 9 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

57.

[REDACTED]

58. [REDACTED]
59. [REDACTED]
60. [REDACTED]
61. [REDACTED]
62. [REDACTED]  
- [REDACTED]  
- [REDACTED]  
- [REDACTED]  
- [REDACTED]  
- [REDACTED]  
- [REDACTED]
63. [REDACTED]

64. Sa më sipër, sjellja e ndërmarrjes Intesa SanPaolo Bank Albania SHA në tregun përkatës, mund të përbëjë shkelje të nenit 4 dhe nenit 9 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e

---

<sup>4</sup> [https://amf.gov.al/ts\\_abs\\_bank\\_agjent.asp](https://amf.gov.al/ts_abs_bank_agjent.asp) dhe [https://amf.gov.al/ts\\_abs\\_bank\\_broker.asp](https://amf.gov.al/ts_abs_bank_broker.asp).

“ konkurrencës”.

65. [REDACTED]
66. [REDACTED]
67. [REDACTED]
68. [REDACTED]
69. [REDACTED]
70. [REDACTED]

71. Sa më sipër, sjellja e ndërmarrjes Union Bank SHA nëpërmjet aktivitetit të E-Business Solutions SHPK, me të cilin ka pronësi aksionare të përbashkët, mund të përbëjë shkelje të nenit 4 dhe nenit 9 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

72. [REDACTED]

---

<sup>5</sup> [https://amf.gov.al/ts\\_abs\\_bank\\_aagent.asp](https://amf.gov.al/ts_abs_bank_aagent.asp) dhe [https://amf.gov.al/ts\\_abs\\_bank\\_broker.asp](https://amf.gov.al/ts_abs_bank_broker.asp).

73.

[REDACTED]

74.

[REDACTED]

75. Sa më sipër, sjellja e ndërmarrjes ABI Bank SHA, nëpërmjet aktivitetit të Abi Broker Sigurimesh SHA, e cila zotërohet 100% nga ABI Bank, mund të përbëjë shkelje të nenit 4 dhe nenit 9 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

76.

[REDACTED]

77.

[REDACTED]

78.

[REDACTED]

79.

[REDACTED]

80. Sa më sipër, sjellja e ndërmarrjes Banka e Bashkuar e Shqipërisë SHA në tregun përkatës, mund të përbëjë shkelje të nenit 9 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

81.

[REDACTED]

82.

[REDACTED]

83. Sa më sipër, sjellja e ndërmarrjes Banka e Parë e Investimeve SHA, në tregun përkatës, mund të përbëjë shkelje të nenit 9 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

84. [REDACTED]

[REDACTED]

[REDACTED]

[REDACTED]

[REDACTED]

[REDACTED]

85. Sa më sipër, sjellja e ndërmarrjes Procredit Bank SHA në tregun përkatës, mund të përbëjë shkelje të nenit 4 dhe nenit 9 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

#### PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 9, nenin 24, germa (d), nenin 26 dhe nenin 43, pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

#### VENDOSI:

- I. Hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete për ndërmarrjet: OTP Bank Albania SHA, Banka Kombëtare Tregtare SHA, Credins Bank SHA, Banka Raiffeisen SHA, Banka e Tiranës SHA, Intesa SanPaolo Bank Albania SHA, Union Bank SHA, E-Business Solutions SHPK, Banka e Bashkuar e Shqipërisë SHA, Banka Amerikane e Investimeve SHA dhe Abi Broker Sigurimesh SHA dhe në tregun e kredidhënies me sigurim jete për kreditë që jepen brenda bankës Bankës së Parë të Investimeve SHA dhe Bankës Procredit SHA.
- II. Hetimi i thelluar do të përfshijë periudhën kohore nga 07.11.2021 deri në 26.03.2025.
- III. Raporti i hetimit të thelluar duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj nga marrja e këtij vendimi.
- IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### KOMISIONI I KONKURRENCËS

Leida MATJA

Zv. Kryetar

Rezana KONOMI

Anëtar

Durim KRAJA

Anëtar

Fatjola DELIJA

Anëtar

Denar BIBA

Kryetar

